

L I G J

Nr.7824. datë 18.5.1994

PER NJE SHTESE NE LIGJIN NR.7745, DATE 26.7.1993 "PER RIVLERESIMIN DHE SHPERNDARJEN NE VLERE TE PASURISE SE ISH-KOOPERATIVAVE BUJQESORE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991
"Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit
të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7745, datë 2.7.1993 "Për rivlerësimin dhe
shpërndarjen në vlerë të pasurisë së ish-kooperativave
bujqësore", pas nenit 1 shtohet neni 1/a me këtë përmbajtje:

"Objektet socialkulturore, pasuri e ish-kooperativave
bujqësore, që ekzistojnë fizikisht, të ndërtuara e përdorura për
nevojat e arsimit, kulturës, sporteve, shëndetësisë, dhe zyrat e
ish-këshillave popullore dhe ish-kooperativave bujqësore kalojnë
kundrejt shpërblimit pasuri e komunës ose bashkisë, me vendim të
këshillit përkatës, për t'u përdorur për nevoja publike nga vetë
komuna ose bashkia si dhe për dhënien me qira të tyre për të
njëjtin qëllim. Shpërblimi të bëhet brenda 3 vjetëve.

Objektet socialkulturore të sipërpërmendura, kur janë
zënë në mënyrë të paligjshme nga subjekte të ndryshme, mbi bazën
e vendimit të këshillit përkatës lirohen brenda 1 muaji. Për
rastet kur objekti është adaptuar për banesë dhe shtetasi nuk ka
banesë tjetër, ky afat zgjatet deri në 6 muaj. Kur në këto
objekte janë sistemuar për banim ish-të përndjekurit politikë që
kanë fituar statusin sipas ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 "Për
statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga
sistemi komunist", lirimi i tyre bëhet me plotësimin nga shteti
të detyrimeve që rrjedhin nga statusi për këtë kategori
shtetasish.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr., datë të Presidentit të Republikës së
Shqipërisë, Sali Berisha